

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Zabeli kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.P., nga Gjakova, rr. "...", për shkak të veprës penale nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtës të të akuzuarit V.P. av. B.M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.366/14, datë 27.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17.07.2017, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtës të të akuzuarit V.P. av. B.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.366/14, datë 27.03.2017, **Vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin P.nr.366/14, datë 27.03.2017, të akuzuarin V.P., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163, dhe e ka gjykuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afatin prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale. E dëmtuara Komisioni i Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Është detyruar i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit V.P. -av. B.M., në ankesë nuk i precizojnë arsyet e goditjes së vendimit por nga përmbajtja del se aktgjykimin e kanë atakuar për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim me të butë.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.696/2016, datë 15.06.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e përbashkët e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

**Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtisi i të akuzuarit në ankesë pretendon se në aktgjykimin e shkallës së parë, gjykata e shkallës së parë i ka falur besimin deklaratave të njëanshme të punësuarve të palës së dëmtuar: Z.S., L.Ç. dhe Sh.H., të cilët janë dëgjuar nga gjykata në cilësi të dëshmitarëve, edhe pse këta dëshmitar me asnjë provë valide nuk e kanë vërtetuar faktin se, punëtorët të cilët janë gjetur ditën kritike në vend të ngjarjes kanë qenë punëtor të akuzuarit dhe të angazhuar nga ana e të akuzuarit, bazuar në faktin jokontestues se as zyrtarët e palës së dëmtuar të sipër përmendur, në deklaratat e të cilëve gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin e ka atakuar me ankesë dhe as zyrtarët policor nuk e kanë bërë identifikimin e punëtorëve të gjetur në vend të ngjarjes janë angazhuar për punë nga i akuzuari, rrethanë kjo relevante për të vendosur lidhur me përgjegjësi eventuale të akuzuarit, zyrtarët e palës së dëmtuar Z.S., L.Ç. dhe Sh.H., por as zyrtarët policor, të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes ditën kritike, po ashtu nuk kanë vërtetuar faktin se kamioni dhe eskavatori i gjetur në vend të ngjarjes kanë qenë në pronësi të akuzuarit, apo se janë marrur në shfrytëzim me qira nga i akuzuari, me çka vërtetohet se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetoj drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit, nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejt pretendohet në ankesën e ushtruar. Se i akuzuari, ka kryer veprën penale nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163, pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë gjykata e shkallës së parë i ka nxjerrë të gjitha provat e domosdoshme dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimin të ankimuar dhe këtë e bëri duke dëgjuar dëshmitarin Z.S., L.Ç., Sh.H., Sh.J., Gj.Gj. dhe A.Sh., si dhe ka administruar edhe provat materiale që janë propozuar nga palët dhe atë raportin e shfrytëzimit ilegal të datës 11.09.2015 së bashku me fotot e vendit të ngjarjes dhe foton e letërnjoftimit të akuzuarit, urdhëresën për ndërprerjen e aktivitetit minerarë dhe sekuestrimin e mjeteve të punës dhe minerare të datës 11.09.2013, raportin mbi kultivimin e vëllimit me numër

7209 të datës 23.10.2013, raporti për operim ilegal me numër 7623 të datës 06.11.2013, aktvendimi me numër 4310 të datës 08.11.2013, raportin i oficerit A.Sh. me numër të rastit 2013-OP-1253 i datës 11.09.2013, si dhe ka shikuar 6 fotografit me ngjyra të bëra nga inspektorët e KPMM në vendin e ngjarjes. Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se nuk është kontestuese fakti se i akuzuari V.P., ishte zënë nga ana e inspektorëve të KPMM-së në fshatin Babaj të Bokës, komuna e Gjakovës, duke operuar ilegalisht në shfrytëzimin e rërës kuarcore pa pasur licencë përkatësisht leje për aktivitetet të veçanta nga ana e KPMM-së. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka ardhur në përfundim se duhet ti falet besimi dëshmisë së dëshmitarëve Z.S. L.Ç. dhe Sh.H., ngase dëshmitë e tyre janë në harmoni me provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor por edhe me dëshmitë e dëshmitarëve Sh.J., Gj.Gj. dhe A.Sh., të cilëve po ashtu gjykata iu ka falur besimin. Nga dëshmia e dëshmitarëve Z.S., L.Ç. dhe Sh.H. inspektorë të KPMM-së. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se ditën kritike këta inspektorë në fshatin Babaj të Bokës, i kishin zënë punëtorët e të akuzuarit, duke operuar ilegalisht, përkatësisht duke bërë shfrytëzimin e rërës kuarcore pa pasur licencë-leje për aktivitetet të veçanta, ku që të tre, kanë theksuar se edhe pse kanë kërkuar nga të njëjtit lejen përkatësisht licencën, të njëjtëve nuk i është ofruar asnjë dokument ligjorë, licenca nga ana e KPMM-së apo leje e ndonjë organi tjetër për zhvillimin e atij aktiviteti përkatësisht shfrytëzimin e rërës kuarcore. Inspektorët pas bisedimit me të akuzuarin V. e kishin lëshuar edhe urdhëresën për ndalimin e aktivitetit minerar, ngase asnjë aktivitet resursit minerar, nuk lejohet pa leje të KPMM-së qofshin persona fizik apo ndërmarrja dhe atë pa marrë parasysh se a është tokë private apo shtetërore, duhet të pajiset me licencë të shfrytëzimit apo leje për aktivitete të veçanta. Ashtu që pas lëshimit të kësaj urdhërese nga ana e inspektorëve të KPMM-së, i akuzuari e kishte tërheqë makinerinë përkatësisht kamionin dhe eskavatorin që është zënë në vendin e ngjarjes. Po ashtu gjykata e shkallës së parë me të drejtë sipas vlersimit të kësaj gjykate, këto fakte i vërteton edhe nga dëshmia e dëshmitarëve Sh.J., Gj.Gj. dhe A.Sh. që të tre zyrtarë policor të cilët kanë deklaruar se iu kanë asistuar inspektorëve të Minierave dhe Mineraleve në fshati Babaj të Bokës, ku në këtë vend është zënë kamioni dhe eskavatori dhe pasi që inspektorët kanë biseduar me V. P. makineria është larguar nga vendi i ngjarjes. Po ashtu se i akuzuari e kishte bërë shfrytëzimin e rërës kuarcore gjykata e shkallës së parë këto fakte i ka vërtetuar nga foto-dokumentacionet që janë bërë ditën kritike, nga ana e inspektorëve, ku nga këto foto shihet qartë operimi me makineri të rëndë për shfrytëzimin e resursit minerar. Sa i përket pretendimit nga ana e mbrojtjes se personat që janë gjetur në vendin e ngjarjes nuk kanë qenë punëtor të akuzuarit e as të angazhuar nga ana e tij dhe se kamioni dhe eskavatori që kanë vepruar në vendin e ngjarjes nuk kanë qenë në pronësi të tij dhe as në shfrytëzim nga ana e tij, për gjykatën e shkallës së parë këto pretendime janë të pabazuara dhe të pa argumentuara ngase gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor mbrojtja nuk ka prezantuar ndonjë provë që do të dëshmonte se kjo makineri ka qenë e dikujt tjetër, po ashtu nuk ka prezantuar ndonjë provë për të cilën do të dëshmonte se punëtorët nuk kanë qenë punëtor të tij, prandaj gjykata mbrojtjes së të akuzuarit dhe deklaramit të tij nuk ia ka falur besimin ngase gjykata e shkallës së parë konsideron se e njëjta bëhet me qëllim të

shmangies nga përgjegjësia penale. Nga provat e lartcekura në pa mëdyshje nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se i akuzuari ka krye veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, për çka me të drejtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë të akuzuarin e lartcekur e ka shpallur fajtor. Një gjendje të tillë faktike si të drejtë dhe të ligjshme e aprovoj edhe kjo gjykatë.

Sa i përket vendimit për dënim, mbrojtësi i tij me ankesë pretendonë se edhe me supozimin se i akuzuari ka kryer veprën penale të sipër përmendur parashtruesi i ankesës pretendon se dënimi është i ashpër dhe se janë plotësuar kushtet që të akuzuarit ti shqiptohet jo vetëm dënimi minimal i paraparë me ligje, por edhe dënim me i butë konform nenit 65 par. 1 të KPP-së, respektivisht janë plotësuar kushtet që të akuzuarit ti shqiptohet dënim edhe nën kufirin e paraparë me ligje, apo ti shqiptoj dënim me të butë, respektivisht ti shqiptoj vërejtje gjyqësore, me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit, duke marrë për bazë faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar dhe se gjatë gjykimit ka qenë korrekt, faktin të cilin e ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, mirëpo e ka anashkaluar me rastin e vendosjes lidhur me dënimin, gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk ka konstatuar asnjë rrethanë rënduese, e cila do ti shërbente gjykatës shqiptimin e dënimit maksimal në kohëzgjatje prej 6 muajve dhe gjoba administrative, bazuar në dispozitën e nenit 80 par. 1 të Ligjit për Miniera dhe Minerale, dhe se konsiderohet se kjo shkelje ka zgjatur vetëm një ditë dhe këtë me datë 11.09.2013. I akuzuari veprën penale nga neni 80, par.1 të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163, për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas aktgjykimit të atakuar me këtë ankesë, nuk e ka kryer as me dashje direkte, e as me dashje eventuale, por as që e ka dëshiruar kryerjen e veprës së tillë penale, kështu që për këtë arsye mund të thirret përfundimi se i akuzuari konform dispozitave të nenit 21 par.1 dhe 2 të KPK-së, Nr.04/L-082, e lidhur me dispozitat e nenit 17, par.1 të këtij Kodi Penal, nuk konsiderohet përgjegjës për kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar me aktgjykimin e atakuar me këtë ankesë, kështu që për këtë arsye Gjykata e shkallës së parë edhe me supozim se i akuzuari e ka kryer veprën penale kontestuese, është dashur që të akuzuarin ta dënoj me dënim më të butë, dhe këtë duke i shqiptuar Vërejtjen Gjyqësore konform nenit 86 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të mbrojtësit sa i përket vendimit mbi dënimit, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit, pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç'rast si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh rrethanat personale se është i martuar, babai 9 fëmijve, se është mbajtës i familjes 13 antarëshe, i gjendjes së dobët ekonomike, se nuk ka punë të rregullt se në gjykimin ka qenë tejet korrekt, se më parë nuk ka qenë i gjykuar ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur dhe të akuzuarit i ka shqiptue dënim me kushte si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së

shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj rëndësie që të ndikonin në shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë e re lehtësuese, e cila kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr.675/17, datë 17.07.2017

Bashkëpunëtori profesional  
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit  
Gani Zabeli

### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani  
Shqipe Qerimi